



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:301178

Datë: 18.12.2024

Numri i dokumentit: 06617748

**C.nr.3278/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË MIROVICË**, si kontestimore, me Gjyqtarin Blerim Istrefi, në çështjen juridike të paditëses L.S. nga Mitrovica, përfaqësuar nga Sheremet Ademi dhe Leutrim Ademi av. me seli në Mitrovicë, ndaj të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore ,Drejtoria Komunale e Arsimit, Objekti i Kontestit: Për kompensimin e të ardhurave personale, jashtë seance me dt. 18.12.2024 nxjerr këtë;

**A K T V E N D I M**

Padia e paditëses L.S. nga Mitrovica, e parashtruar në këtë gjykatë me dt. 26.09.2024, ndaj të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore ,Drejtoria Komunale e Arsimit, Objekti i Kontestit:Për kompensimin e të ardhurave personale, **KONSIDEROHET E TËRHEQUR**.

**A r s y e t i m**

Paditësja L.S., përmes të autorizuarit, ka ushtruar padi me dt. 26.09.2024, ndaj të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore-Drejtoria Komunale e Arsimit, Objekti i Kontestit:Për kompensimin e të ardhurave personale.

Gjykata, me aktvendimin e dt. 11.11.2024, të pranuar nga i autorizuari i paditëses me dt: 09.12.2024, ka kërkuar nga paditësja që brenda afatit 3 ditor ta plotësoj- precizoj padinë, me paralajmërimin konform nenit 99 dhe 102 te LPK-së.

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se paditësja nuk ka vepruar brenda afatit të përcaktuar nga gjykata për plotësimin- precizin e padisë, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 102.par 3 të LPK-së, padinë e paditëses L.S. nga Mitrovica, e parashtruar në këtë gjykatë me dt. 26.09.2024, ndaj të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, Objekti i Kontestit: Për kompensimin e të ardhurave personale e **KONSIDEROJ TË TËRHEQUR**.

Andaj nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv te këtij aktvendimi e në vështrim të nenit 102.par 3 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.nr.3278/2024 me dt.18.12.2024**

**GJYQTARI**  
Blerim Istrefi

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta në ankesë në afatin prej 7 ditësh prej ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.